



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË -AUTORITETI I KONKURENCËS-

---

### Njoftim për shtyp

#### **Mbi Vendimin “Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e prokurimit të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes”**

Komisioni i Konkurrencës në mbledhjen e tij të datës 31.10.2014 shqyrtoi raportin e monitorimit të tregut të importit të energjisë elektrike nga CEZ SHA për mbulimin e humbjeve”. Përpara marrjes së vendimit përfundimtar Komisioni zhvilloi edhe një takim konsultues me Bordin Drejtues të ERE.

*Në konkluzion Komisioni i Konkurrencës vendosi t’i rekomandojë ERE-s që në përmbushje të qëllimit për mirëfunksionimin e tregut të energjisë elektrike, për rritjen e konkurrencës në tregun përkatës të blerjes së energjisë elektrike, që në kushtet e ndryshuara të statutit të shoqërisë pas marrëveshjes së mirëkuptimit me CEZ, të rishikojnë procedurat e blerjes së energjisë elektrike mujore dhe vjetore për OSHEE.*

Komisioni çmon se rekomandimet janë të vlefshme në periudhën afatshkurtër (meqënëse tenderat janë në periodicitet mujor) deri në momentin e miratimit të pligjit “Për energjinë elektrike” dhe miratimin e Modelit të ri të Energjisë.

Rekomandimet synojnë (a) nxitja e pjesëmarrjes në procedurat e blerjes së energjisë, (b) Nxitja e konkurrencës ndërmjet blerësve; (c) sigurimi i trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë pjesëmarrësit në procedurën e blerjes së energjisë; dhe (d) sigurimi i integritetit, besimit publik dhe transparencës në procedurat e blerjes së energjisë elektrike dhe kosto sa me te uleta per keto lloj transaksionesh.

Komisioni i Konkurrencës ka rekomanduar të rishikohet vendimi 30, datë 23.3.2001 i ERE-s “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të blerjes nga KESH SH.A...” duke specifikuar që pranimi, vleresimi dhe negocimi i ofertave të kryhet në prani të ofertuesve duke rritur në këtë mënyrë besueshmërinë e procesit dhe konkurrencën ndërmjet ofruesve dhe duke hapur tregun dhe lejuar te gjithë aktoret e tregut (edhe prodhuesit vendas të energjisë) të marrin pjese ne procedurat e tenderit duke e bere ne kete menyre me konkurrues procesin.

Gjithashtu mënyra e përcaktimit të ofertës fituese të përshtatet sipas Rregullores së Ministrisë së Financave “Për emetimin e obligacioneve”, “kërkesat konkurruese pranohen si fituese duke filluar nga ato që kanë çmimin më të ulët deri në plotësimin e sasisë së energjisë së kërkuar”.

Duke marrë në konsideratë faktin që aktualisht në Shqipëri të gjitha procedurat e prokurimit publik janë në formë elektronike dhe realizohen nëpërmjet platformave përkatëse elektronike, Komisioni i Konkurrencës rekomandon që kjo procedurë të parashikohet edhe në rregullat e blerjes së energjisë elektrike.